



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 3:	MASAT SPECIFIKE PARANDALUESE
Tema 3.3.	MASAT EMERGJENTE, NDIHMA E PARË
Ligji / rregulloret përkatëse:	<ul style="list-style-type: none">● Ligji Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;● Rregullore (MPMS) Nr.4/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;● Rregullore (MPMS) Nr.01/2020;● Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë.
Shkurtesa:	<ul style="list-style-type: none">● MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Lista kontrolluese nuk është e zbatueshme në: <ul style="list-style-type: none">● Forcën e Sigurisë së Kosovës, Polici, Shërbimin e Zjarrfikësve dhe Shërbimet e Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Dispozitat e Ligjit nuk zbatohen);● Transportin rrugor, hekurudhor, ujqor të brendshëm, detar ose ajror në lidhje me shenjat e sigurisë (Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 nuk është e zbatueshme në ato industri);● Mjetet e transportit të përdorura jashtë ndërmarrjes së vendeve të punës, mjetet e transportit të brendshëm; lokacionet e përkohshme ose të lëvizshme të punës; aktivitetet minerare sipërfaqësore ose nëntokësore; anije peshkimi; fusha, pyje dhe pjesë tjetër përbërëse e një ndërmarrje bujqësore ose pyjore, por të vendosura larg ndërtesave dhe territorit të ndërmarrjes (Rregullore (MPMS) Nr.4/2014 nuk është e zbatueshme në këto situata).
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS			
	<i>* Bëhuni gati për vizitën në lokacion - nëse nuk i mbani mend kërkesat tuaja të brendshme për daljen emergjente, zjarrfikjen ose ndihmën e parë, lexojini përsëri dokumentet për të qenë gati për vizitën në lokacion!</i>			

	<p><i>* Gjatë vizitës në vendet e punës, do t'ju duhet të mbani shënime. Është më e lehtë të mbani shënime të strukturuar, për shembull duke përdorur formularët e inspektimit. Merrini me vete. Përmbajtja e formularëve të inspektimit varet nga vendi i punës që do të vizitoni. Nëse nuk keni formularë inspektimi, përgatitni formularë të mirë dhe lehtësisht të kuptueshëm (p.sh. duhet të përfshihet vendi i inspektimit, data/ora, ekipi i inspektimit dhe të punësuarit e inspektuar, lista e lokacioneve të kutive të ndihmës së parë ose aparateve kundër zjarrit).</i></p>			
MBIKËQYRJA E LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS				
	<p><i>* Bëhu shembull, respektoni kërkesat e sigurisë që ekzistojnë në lokacion / vendet e punës!</i></p> <p><i>* Merrni shënime për vendet vëzhguara të punës dhe bëni fotografi të vendosjes/mungesës së masave emergjente (kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë).</i></p> <p><i>* Bisedoni me punëtorët sa e rëndësishme është të jesh gati për emergjenca!</i></p>			
PROCEDURAT E EMERGJENCËS				
1.	<p>A ka ndonjë plan për evakuim dhe shpëtim?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, nenet 11.5, 15.1.2</p> <p><i>* Kontrolloni nëse ka të paktën një plan evakuimi në secilin kat të ndërtesës.</i></p> <p><i>* Kontrolloni nëse plani korrespondon me situatën reale (p.sh. vendndodhja e pajisjeve për zjarrfikje, daljet emergjente, pika e sigurt e grumbullimit etj.).</i></p>			


2.	<p>A ekziston një plan i mbrojtjes nga zjarri, duke përfshirë specifikimin e pajisjeve kundër zjarrit?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 9</p>			
3.	<p>A ka pasur ushtrime praktike në përputhje me planin për të gjithë punëtorët të paktën një herë në dy vjet?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 11.5</p> <p><i>* Shqyrtoni planifikimin për trajnimet për emergjenca - përmbajtja e trajnimit duhet të jetë e ndryshme në varësi të rreziqeve që ekzistojnë në vendin e punës - p.sh. veprimet që duhet të ndërmerren nëse ka pasur rrëzime kur është punuar në lartësi, kjo procedurë është e ndryshme nga zjarri në zyrë.</i></p> <p><i>* Përgatitni skenarë të ndryshëm për trajnim praktik (p.sh. një herë mund të ketë zjarr në ambientet tuaja, herën tjetër lirim të kimikateve, një herë tjetër ka nevojë për evakuim për shkak të sulmit në zemër të një të punësuarit etj.). Sa më shumë të investoni në skenarë, aq më të gatshëm do të jeni për raste emergjente reale!</i></p> <p><i>* Kontrolloni nëse keni dëshmi për trajnimin (p.sh. dokumente regjistrimi për ushtrime praktike).</i></p>			
4.	<p>A ekziston një procedurë për të kontaktuar shërbime të jashtme, veçanërisht në lidhje me ndihmën e parë, kujdesin emergjent mjekësor, shërbimet e shpëtimit dhe shërbimin e zjarrfikësve?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, neni 11.6</p>			

	<p><i>* Pyetni të gjithë punëtorët se çfarë do të bënin nëse ka nevojë për shërbime të jashtme emergjente.</i></p> <p><i>* Shikoni nëse ka numra telefoni në dispozicion për shërbime të jashtme, veçanërisht në lidhje me ndihmën e parë, kujdesin emergjent mjekësor, shërbimet e shpëtimit dhe shërbimin e zjarrfikësve (p.sh. numrat e vendosur në mure pranë telefonave).</i></p> <p><i>* Pyetni të gjithë punëtorët nëse i dinë numrat e telefonit për shërbimet e jashtme, veçanërisht në lidhje me ndihmën e parë, kujdesin emergjent mjekësor, shërbimet e shpëtimit dhe shërbimin e zjarrfikësve.</i></p>			
5.	<p>A ndalohej pirja e duhanit në vendet e punës, duke përfshirë dhomat e pushimit?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.15 Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 20</p> <p><i>* Kontrolloni nëse punëtorët i respektojnë rregullat e ndalimit të pirjes së duhanit. Kjo vlen posaçërisht për industrinë me risk të lartë nga zjarri, p.sh., punimi i drurit, industria shtypshkronjave, ndërtimtaria etj.</i></p>			
6.	<p>A janë të vendosura shenjat e ndalimit të pirjes së duhanit në vendet e punës dhe në vendet publike?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.15 Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 3.1</p>			

		<p>Ndalohet pirja e duhanit.</p>			
		<p>Ndalohet pirja e duhanit dhe përdorimi i flakës së hapur.</p>			
RRUGËT DHE DALJET EMERGJENTE					
	<p>* Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për rrugët e daljes emergjente nga disa pika të lokacionit.</p> <p>* Ecni nëpër të gjitha rrugët e daljes emergjente për të identifikuar nëse mund të arrini në një pikë të sigurt të grumbullimit vetëm duke ndjekur shenjat e sigurisë. Filloni me vendet më të largëta të punës si pikënisje për të kontrolluar rrugët e emergjencës. Rrugës mund të kontrolloni nëse rrugët e daljes janë të lira, mjaftueshëm të gjera, nëse dyert janë të kyçura ose bllokuara, nëse ka shenja të mjaftueshme sigurie, kontrolloni pajisjet kundër zjarrit, kutitë e ndihmës së parë, etj.</p>				
7.	<p>A ka numër të mjaftueshëm të rrugëve dhe daljeve emergjente?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 4.3 Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, neni 15.1.1</p> <p>* Numri, shpërndarja dhe dimensionet e rrugëve dhe daljeve të emergjencës varen nga përdorimi, pajisjet dhe</p>				

	<p><i>dimensionet e vendeve të punës dhe numri maksimal i personave që mund të jenë të pranishëm. Mos harroni se industri specifike mund të kenë kërkesa specifike - p.sh. dalje më të gjera emergjente për spitalet nëse duhet të evakohen pacientë të shtrirë, dhe kur numri i personave që do të evakohen mund të jetë shumë më i lartë sesa punëtorët - p.sh. klientët në qendrat tregtare.</i></p>			
8.	<p>A janë të qarta dhe të lira nga pengesat rrugët, daljet, dyert e emergjencës, dhe rrugët e trafikut që të mund të përdoren në çdo kohë pa pengesa?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 4.1, 4.6.1, 5, duke përfshirë ndryshimet nga Rregullore (MPMS) Nr.01/2020</p> <p><i>* Një problem i zakonshëm është se rrugët dhe daljet emergjente përdoren si vend depozitimi, duke i ngushtuar kështu daljet, çka mund të jetë jetike gjatë emergjencës. Ky është një shembull jo i mirë i mirëmbajtjes së rrugëve të emergjencës.</i></p> <p><i>* Kushtojini vëmendje sipërfaqes së rrugëve, e cila duhet të jetë e rrafshët për të mos shkaktuar rrëshqitje, pengime dhe rrëzime që rezultojnë në punëtorë të lënduar dhe rrugë të bllokuara gjatë emergjencës.</i></p>			
9.	<p>A të dërgojnë rrugët dhe daljet e emergjencës drejtpërdrejt (sa më shpejt të jetë e mundur) në ajër të hapur ose në zonë të sigurt ku punëtorët mund të evakohen me shpejtësi dhe siguri?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 15.1.4.</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 4.1, 4.2,</p>			








	<p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 28</p> <p><i>* Pyetni të gjithë punëtorët nëse e dinë se ku është dalja më e afërt e emergjencës dhe pika e sigurt e grumbullimit.</i></p>			
10.	<p>A hapen nga jashtë dyert e emergjencës?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 4.4</p> <p><i>* Arsyeja pse dyert duhet të hapen nga jashtë ka të bëjë me faktin se në rast se do të ketë turmë brenda ambienteve të kompanisë, fizikisht nuk do të jetë e mundur të hapen dyert nga brenda, pasi turma do t'i shtyjë njerëzit e tjerë përpara për të dalë sa më shpejt nga vendi i emergjencës.</i></p>			
11.	<p>A janë rrugët dhe daljet emergjente pa dyer rrëshqitëse dhe rotulluese?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 4.4.1</p>			
12.	<p>A është e mundur të hapen të gjitha dyert e emergjencës nga çdo person në çdo kohë nga brenda?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 4.4.2, 4.6</p> <p><i>* Dyert e emergjencës nuk duhet të kyçen. Kyçja e dyerve dhe mbajtja e çelësit nga ndonjë mbikëqyrës ose në pikën e sigurisë nuk është një praktikë e mirë. Kjo dispozitë duhet të sigurohet përmes dizajnit teknologjik që lejon hapjen e dyerve vetëm nga brenda, ose çelësat duhet të mbahen pranë dyerve (p.sh. në një kuti specifike me një mbulesë xhami që duhet të thyhet gjatë emergjencës).</i></p>			


13.	<p>A ka ndriçim të mjaftueshëm në rrugët dhe daljet emergjente (përfshirë ndriçimin e emergjencës në rast se dështon ndriçimi)? A është niveli i ndriçimit për orientim të thjeshtë ndërmjet 50 dhe 100 lux /lumen/m²?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 8 <i>* Kontrolloni ndriçimin në rast dështimit - për këtë inspektim zgjidhni objektet ku nuk ekziston ndriçimi natyror. Përfshini dështimin e ndriçimit në trajnimet e ardhshme praktike për ta testuar këtë në situatën e trajnimit!</i></p>			
14.	<p>A janë shënuar rrugët e daljes emergjente?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, neni 15.1.3 Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I Neni 2.1.1</p> 			
15.	<p>A ka pajisje personale mbrojtëse në dispozicion për vendet e veçanta të punës për të mbrojtur punëtorët në raste emergjente (p.sh. respiratorë, maska me konsumim të oksigjenit)?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.16 <i>* Mos harroni se një mbrojtje e tillë specifike personale është e nevojshme në industri me risk të lartë, p.sh. kur</i></p>			

	<p><i>është i mundur lirimi i substancave kimike. Kjo pajisje përdoret për të dalë nga ambientet në pikën e sigurt të grumbullimit;</i></p> <p><i>* Pyetni të gjithë punëtorët nëse kanë nevojë për ndonjë pajisje specifike personale mbrojtëse për evakuim (nëse kanë nevojë - ju duhet ta dini para kësaj vizite mbikëqyrëse, përndryshe nuk do të jeni në gjendje ta kontrolloni) dhe nëse po, ku ndodhet.</i></p>			
16.	<p>A është e mirëmbajtur kjo pajisje personale mbrojtëse dhe me afatin e vlefshëm të shfrytëzimit?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.16</p> <p><i>* Zakonisht kjo pajisje specifike mbrojtëse personale ruhet në një vend të veçantë dhe destinohet vetëm për situata emergjente. Kontrolloni të gjitha pajisjet nga secili lloj për të kontrolluar afatin e përdorimit.</i></p>			
OFRIMI I NDIHMËS SË PARË				
17.	<p>A ka një vend të caktuar për ofrimin e ndihmës së parë (një ose më shumë dhoma të ndihmës së parë në varësi të llojit të veprimtarisë që kryhet dhe shpeshtësisë së aksidenteve)?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 15.1.5</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 19.1</p> <p><i>* Mos harroni (sa më i lartë është risku - aq më shumë dhoma të ndihmës së parë janë të nevojshme, sa më e madhe është kompania - aq më shumë dhoma të ndihmës së parë janë të nevojshme), megjithatë është në rregull nëse kompanitë e vogla që punojnë në industri</i></p>			

	<i>me risk të ulët të mos sigurojnë dhomë specifike të ndihmës së parë.</i>			
18.	<p>A ka pajisje të mjaftueshme për dhënien e ndihmës së parë (p.sh. barela, barna, garza, pastrues për sy)?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 15.1.5 Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 19.2</p> <p><i>* Mos harroni se kjo pajisje duhet të instalohet afër vendeve të punës - p.sh. larësi i syve duhet të instalohet në vendin ku është i mundur rreziku i futjes së kimikateve në sy, kurse dushet e sigurisë - në vendet ku është i mundur ekspozimi i komplet trupit ndaj kimikateve. Shenja përkatëse e sigurisë duhet të përdoret në ato situata.</i></p> <p><i>* Mos harroni gjithnjë e më shumë kompani instalojnë defibrilatorë të jashtëm të automatizuar në ambientet e tyre (p.sh. supermarkete, banka, etj.). Kjo nuk është një kërkesë ligjore, por një shembull i praktikës së mirë. Konsiderojeni këtë nëse keni punëtorë të moshuar dhe një numër të madh të publikut që vizitojnë kompaninë tuaj!</i></p>			
19.	<p>A ka numër të mjaftueshëm të kutive të ndihmës së parë?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 15.1.5 Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 19.2</p> <p><i>* Kontrolloni nëse ka të paktën një kuti të ndihmës së parë në secilin kat të ndërtesës.</i></p>			






20.	<p>A është lehtësisht e qasshme përmbajtja e kutive të ndihmës së parë?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 15.1.5 Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 19.3</p> <ul style="list-style-type: none"> * <i>Kushtojini vëmendje të gjitha kutive të ndihmës së parë.</i> * <i>Pyetni të gjithë punëtorët se ku ndodhet kutia më e afërt e ndihmës së parë.</i> * <i>Mos harroni të kontrolloni përmbajtjen e të gjitha kutive të ndihmës së parë:</i> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>kutitë duhet të jenë të hapura që punëtorët të mund të kenë qasje në pajisje në rast emergjence;</i> ● <i>kutitë mund të jenë të zbrazura (materialet e përdorura ose të vjedhura) - duhet të ketë një sistem të instaluar si e organizoni furnizimin shtesë për material;</i> ● <i>kutitë mundet (por nuk duhet) të përmbajnë barna me afat të skaduar.</i> 			
21.	<p>A janë shënuar objektet dhe kutitë e ndihmës së parë?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 19.3 Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 2.1.1</p> <ul style="list-style-type: none"> * <i>Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për objektet e ndihmës së parë nga disa pika të lokacionit.</i> * <i>Pyetni të gjithë punëtorët se ku janë objektet e ndihmës së parë.</i> * <i>Mos harroni se nuk ka asnjë shenjë sigurie me “kryq të kuq” në legjislacionin ekzistues. Përkundrazi, si shenjë sigurie duhet të përdoret një kryq i bardhë në prapavijën e gjelbër.</i> 			

		<i>Kuti e ndihmës së parë.</i>			
		<i>Lesë.</i>			
		<i>Dush i sigurisë.</i>			
		<i>Pastrues për sy.</i>			
		<i>Telefon emergjent për ndihmë të parë ose shpëtim.</i>			
		<i>Defibrillator i jashtëm i automatizuar (shembull i praktikës së mirë, i pa specifikuar në legjislacion).</i>			
		<i>Pika e grumbullimit në rast të zjarrit (shembull i praktikës së mirë, e pa specifikuar në legjislacion).</i>			

		<p><i>Këtej (shenjë informuese plotësuese)</i> <i>Kjo shenjë përdoret për të treguar drejtimin në vendet ku mbahen pajisjet e ndihmës së parë, ose pikat e tyre të qasjes.</i></p>			
PAJISJET KUNDËR ZJARRIT					
22.	<p>A ka pajisje të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zjarrfikje?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.10 Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 5.1 * <i>Mbani mend ekzistojnë sisteme të ndryshme të pajisjeve kundër zjarrit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>pajisje portative (p.sh. aparate për zjarrfikje, batanije zjarri);</i> • <i>sisteme fikse (p.sh. hidrant kundër zjarrit, sisteme spërkatëse).</i> 				
23.	<p>A ka numër të mjaftueshëm të aparateve kundër zjarrit me mbushje të duhur sipas llojit të shkakut të zjarrit?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.10 Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 5.1</p>				
24.	<p>A janë lehtësisht të qasshëm aparatet kundër zjarrit?</p>				

	<p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.12</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 5.2</p> <p>* <i>Kushtojini vëmendje të gjithë aparateve kundër zjarrit. Ato duhet të vendosen në mure me një dorezë, jo më lart se 1 m (boca më të rënda) dhe 1.5 m (boca më të lehta) nga toka/dyshemeja. Është më tipike që aparatet kundër zjarrit të bllokohen (por nuk duhet të bllokohen) me objekte të ndryshme (p.sh. materiale).</i></p> <p>* <i>Kontrolloni nëse aparatet kundër zjarrit janë instaluar në distancë të arsyeshme nga ndonjë rrezik i zjarrit (në varësi të rrezikut nga zjarri - brenda maksimumit prej 10-30 m).</i></p>			
25.	A është aparati kundër zjarrit pa dëmtime ose vrima?			
26.	<p>A ka siguresë dhe etiketa sigurie në aparatet kundër zjarrit?</p> <p>* <i>Nëse aparati kundër zjarrit nuk ka siguresë, ky aparat duhet të konsiderohet si i dëmtuar dhe të largohet nga vendi i punës.</i></p> <p>* <i>Nëse aparati kundër zjarrit nuk ka etiketa sigurie, ky aparat duhet të konsiderohet si i dëmtuar dhe të largohet nga vendi i punës.</i></p>			
27.	<p>A janë testuar/inspektuar dhe rimbushur aparatet kundër zjarrit në afatet e përcaktuara në etiketa?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.11</p> <p>* <i>Kontrolloni të gjitha aparatet kundër zjarrit!</i></p>			

	<p><i>* Shqyrtoni procedurën për respektimin e afateve nëse identifikoni aparate me afate të vonuara të servisimit. Kërkoni shkaqet kryesore të situatave të tilla!</i></p>			
28.	<p>A ka hidrantë të instaluar (të nevojshëm vetëm në kompani me risk më të lartë të zjarrit, kur konsiderohet se aparatet kundër zjarrit nuk janë të mjaftueshme për të shuar zjarret)?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.13</p>			
29.	<p>A janë instaluar hidrantët në vende të dukshme, të përshtatshme, dhe a janë të gatshëm për përdorim në çdo kohë?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 13.1.14</p>			
30.	<p>A ka detektorë të duhur dhe të mjaftueshëm të zjarrit dhe sisteme alarmi?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, Neni 5.1</p>			
31.	<p>Tek pajisjet zjarrfikëse, a janë vendosur shënime të përhershme me tabela dhe/ose ngjyra të sigurisë me të kuqe?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 2.1.2, Shtojca IV</p> <p><i>* Kontrolloni të gjitha vendet me pajisje zjarrfikëse nëse këto vende janë shënuar.</i></p>			

		<i> Tub zjarri .</i>			
		<i> Shkallë.</i>			
		<i> Fikës i zjarrit.</i>			
		<i> Telefon emergjent për zjarr.</i>			
		<i> Këtej (shenjë informuese plotësuese) Kjo shenjë përdoret për të treguar drejtimin në vendet ku mbahen pajisjet për zjarrfikje, ose pikat e tyre të qasjes.</i>			
	TRAJNIMI				
32.	A janë punëtorët të trajnuar për të realizuar evakuimin dhe shpëtimin?				

	<p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Nenet 11.3, 11.4</p> <ul style="list-style-type: none"> * <i>Diskutoni me punëtorët e trajnuar për procedurën e emergjencës.</i> * <i>Kërkoni dëshmitë e trajnimit (p.sh. agjenda e trajnimit, certifikatat e trajnimit, dokumentet e regjistrimit të trajnimit, etj.).</i> * <i>Numri i punëtorëve të trajnuar varet nga madhësia e kompanisë - sidoqoftë, parimi duhet të jetë - gjatë kohës së punës duhet të ketë të paktën 2 punëtorë të trajnuar në kompani/vendet e punës/lokacion.</i> 			
33.	<p>A janë punëtorët të trajnuar për ta shuar zjarrin?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Nenet 11.3, 11.4</p> <ul style="list-style-type: none"> * <i>Diskutoni me punëtorët e trajnuar për procedurën e emergjencës.</i> * <i>Kërkoni dëshmitë e trajnimit (p.sh. agjenda e trajnimit, certifikatat e trajnimit, dokumentet e regjistrimit të trajnimit, etj.).</i> * <i>Numri i punëtorëve të trajnuar varet nga madhësia e kompanisë - sidoqoftë, parimi duhet të jetë - gjatë kohës së punës duhet të ketë të paktën 2 punëtorë të trajnuar në kompani/vendet e punës/lokacion.</i> 			
34.	<p>A janë punëtorët të trajnuar për ta ofruar ndihmën e parë?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Nenet 11.3, 11.4</p> <ul style="list-style-type: none"> * <i>Diskutoni me punëtorët e trajnuar për procedurën e emergjencës.</i> 			

	<p>* Kërkoni dëshmitë e trajnimit (p.sh. agjenda e trajnimit, certifikatat e trajnimit, dokumentet e regjistrimit të trajnimit, etj.);</p> <p>* Numri i punëtorëve të trajnuar varet nga madhësia e kompanisë - sidoqoftë, parimi duhet të jetë - gjatë kohës së punës duhet të ketë të paktën 2 punëtorë të trajnuar në kompani/vendet punës/lokacion.</p>			
--	---	--	--	--